



**Die Gewerkschaft.
Le Syndicat.
Il Sindacato.**

Parat e Arkës së Pensionit: Pension për pleqëri apo tërheqje e kapitalit?

Ndryshimet në lidhje me Kontratat Bilaterale dhe revidimi (rishikimi) i Ligjit për Përkujdesje Profesionale (LPP)

Unia Sekretariati qendror
Weltpoststrasse 20
CH-3000 Bern 15
T +41 31 350 21 11
info@unia.ch
www.unia.ch

05.2005/1012.01.ALB.A5/6

Përkujdesja Profesionale (shtylla e dytë) përveq pensionit për Pleqëri/Invaliditet/Kontributeve shtesë AHV/IV/EL (shtylla e parë) ka për detyrë që të siguroarit t'i mundësoj vazhdimin e një standardi jetësor në masë të përshtatshme. Ajo përpiqet, që së bashku me shtyllën e parë, t'ia arrijë qëllimit për të ardhura pensionale prej rreth 60 përqind të rrogës së fundit. Parimisht, parat e Arkës së Pensionit janë pjesë e Pensionit të pleqërisë, i cili ty duhet të të mundësoj një egzistencë më të mirë në pleqëri. Përveq asaj ti ke mundësi që këto të holla t'i ngritësh jo vetëm në formë të pensionit, por, një pjesë apo të gjitha të hollat, t'i ngritësh në para të gatshme.

Që nga hyrja në fuqi e Kontratave Bilaterale 2002 tek shumica, e sidomos te koleget/kolegët jozcvicëran/e, parashtrohet pyetja se çka ndodhë me parat e Arkës së Pensionit? A mund të ngritë kapitalin nëse lëshoj Zvicrën? Apo çka ndodhë nëse bëhem ndërmarrës?
Sindikatat kanë luftuar për një fazë kalimtare prej 5 vitesh, për punëmarrësit nga vendet e Bashkimit Evropian. Deri më 2007 në lidhje me këtë nuk ka ndryshime. Edhe më pas, pra nën rrethana të veçanta mund të ngritet kapitali në formë të parave të gatshme.
Në këtë fletushkë i gjeni ndryshimet më të rëndësishme, të cilat vlejné që nga 2005-shi, të Arkave të Pensionit dhe përgjigje në pyetje mbi temën «Parat e Arkës së Pensionit dhe Kontratave Bilaterale» pas afatit kalimtar 2007.

Vini Re: Ndryshimet në vijim, pra ato të cilat hypin në fuqi prej 1 qershorit 2007, vlejné vetëm për punëmarrësit nga vendet e Bashkimit Evropian, të cilët punojné në Zvicër. Për qytetarët, të cilët nuk janë vendas të një vendi të BE-së nuk ka ndryshime. D.m.th. për ta vlejné edhe të tutje të njëjtat rregullime -sikurse sot- nëse lëshojné Zvicrën:

Revidimi (rishikimi) i përkujdesjes profesionale 2005

Çka sjellë ky revidim (rishikim) i Ligjit për Përkujdesje Profesionale LPP konkretisht?

Me revidimin (rishikimin) futen këto ndryshime:


- Shuma e re e obligueshme për pagimin e Arkës së Pensionit: Të ardhurat vjetore prej 19 350 franga duhet të sigurohen (për paga më të ulëta nuk duhet paguar kontribute në arkën e sigurimit).
- Zbritja për koordinim më e ulët, tani për tani afër 22 575 frangave.
- Kufiri më i lartë i të ardhurave vjetore të siguruara: 77 400 (gjithçka që është mbi këtë shumë nuk duhet të sigurohet në mënyrë të obligueshme).
- Mosha e pensionimit: meshkujt 65; femrat 64 vjet (femrat me vite të lindjes 1942 dhe 1943 kanë të drejtë pensionimi me 62 vjet nëse nuk punojné apo janë të lajmruara si të papunë)
- Shkallëzimi i ri i pensionit invalidor, i ngjashëm me shkallëzimin e sigurimit invalidor (Invaliditeti pre 40%: çerek pensioni (1/4); invaliditeti prej 50%: gjysëm pensioni (1/2); Invaliditeti prej 60%: tri të katërtat (3/4) e pensionit dhe Invaliditeti prej 70%: pensioni i plotë)
- Hyrja në fuqi e pensionit për veja
- Mundësia e re e ngritjes së kapitalit në rast pensionimi: 25% mund t'i ngritësh në para të gatshme edhe nëse ke harruar të lajmërosh arkën tënde të pensionit se dëshiron të tërheqësh kapitalin në para të gatshme tri vite para pensionimit.
- Zbritja e kuotës minimale e të interesit për kapitalin e obligueshëm: kuota minimale e interesit (kamatës) tani për tani është 2,5%.
- Nëse punëdhënësi yt dëshiron ndërrimin e arkës së pensionit apo ndërrimin e planit të pensionimit, atëherë atij duhet miratimi i komisionit të ndërmarrjes. Nëse nuk ekziston në ndërmarrje një komision i tillë, atëherë atij duhet miratimi nga personeli.
- Nëse punëdhënësi yt pretendon ndërrimin e arkës së pensionit, apo ndryshimin e përfitimit, atëherë drejtohu në çdo rast tek sindikata Unia. Arka e pensionit duhet të shkolloj anëtarët këshilltar të fondacionit të arkës së pensionit. Nëse ti je përfaqësues i personelit në një arkë të pensionit, atëherë kontakto Sindikatën Unia. Ne mund të mbështesim gjatë shkollimit me disa kurse kualifikuese.

Rroga mujore - bruto:

Kategoritë e kuotës në Unia 2005

Rroga mujore në Fr.	Kuota mujore	Rroga mujore në Fr.	Kuota mujore
<input type="checkbox"/> deri 999.-	12.-	<input type="checkbox"/> nga 3700.- deri 3999.-	36.-
<input type="checkbox"/> nga 1000.- deri 1299.-	15.-	<input type="checkbox"/> nga 4000.- deri 4499.-	38.-
<input type="checkbox"/> nga 1300.- deri 1599.-	18.-	<input type="checkbox"/> nga 4500.- deri 4999.-	40.-
<input type="checkbox"/> nga 1600.- deri 1899.-	21.-	<input type="checkbox"/> nga 5000.- deri 5499.-	42.-
<input type="checkbox"/> nga 1900.- deri 2199.-	24.-	<input type="checkbox"/> nga 5500.- deri 5999.-	44.-
<input type="checkbox"/> nga 2200.- deri 2499.-	26.-	<input type="checkbox"/> nga 6000.- deri 6499.-	46.-
<input type="checkbox"/> nga 2500.- deri 2799.-	28.-	<input type="checkbox"/> nga 6500.-	48.-
<input type="checkbox"/> nga 2800.- deri 3099.-	30.-	<input type="checkbox"/> Sheqerët	7.-
<input type="checkbox"/> nga 3100.- deri 3399.-	32.-	<input type="checkbox"/> Anëtarët e papunë	10.-
<input type="checkbox"/> nga 3400.- deri 3699.-	34.-	<input type="checkbox"/> Pensionistët	10.-

Fr.



Geschäftswortendung Invia commerciale-risposta
Envoi commercial-réponse

Nicht frankieren
Ne pas affranchir
Non affrancare

Mënyra e pagesës: mujore

tremujore

vjetore

Unia

Weltpoststrasse 20
Postfach 272
CH-3000 Bern 15

Kontratat Bilaterale dhe ndryshimet duke filluar nga qershori 2007

Unia lufton për të Drejtat tua

Me 200 000 anëtarë dhe gati 100 sekretariate Unia është, me dallim të qartë, shoqata më e madhe e punëtorëve në Zvicër. Ajo arritë Kontrata të Përgjithshme të Punës me kushte të mira të punës, angazhohet për ligje sociale dhe i ofron anëtarëve siguri, mbrojtje dhe shumë mundësi për përfitime praktike përmes shërbimeve profesionale.

Sindikata Unia dhe anëtarët e saj angazhohen për një botë më të mirë të punës, siguri sociale dhe bashkëjetesë të barabartë me vendasit dhe migrantët tjerë:

- Unia këshillon dhe ndihmon në çështjet e së drjetës së migrantëve dhe sigurimeve sociale/shoqërore.
- Unia përcjell me zgjuarësi problemet gjatë realizimit të marrëveshjeve bilaterale.
- Përveç kësaj Sindikata Unia të dërgon rregullisht informacione dhe gazetën sindikale Horizonte në gjuhën tënde amtare.
- Në shumë seksione ti gjenë Sindikalist kompetent i cili të këshillon në gjuhën tënde amtare.

Deri kur mund të tërheq kapitalin?

Deri në fund të majit 2007 nuk do të ketë ndryshime as për qytetarë të BE-së e as për të tjerët. Në rast të largimit definitiv nga Zvicëra , para pensionimit, kaptali egzistues i pleqëris mund të ngritet në para të gatshme.

Mirëpo, kujdes: Në rast të penszionimit apo të pensionimit të mëhershëm pagesa me parat e gatshme mund të bëhet, nëse rregulloret e Arkës tënde të pensionit e parashohin këtë. Sipas rregullit, kjo duhet të paralajmërohet në një afat të caktuar (informohu te Arka jote e Pensionit) para datës së pensionimit. Kjo vlenë edhe në rast të pensionimit të mëhershëm.

Çka ndryshon prej qershorit 2007 dhe për kend?

Prej 1 qershorit 2007 do të ketë ndryshime; këto vlejné vetëm për pjesën e obligueshme të Arkës së Pensionit (LPP-Minimumi) dhe vetëm për vendet e BE-së si dhe Norvegjinë, Islandën dhe Lihtenshtajnin. Për qytetarë të vendeve jashtë BE-së nuk ka ndryshime, gjegjësisht: ende mbeten në fuqi rregullat e deritashme, nëse definitivisht lëshojné Zvicrën.

A është e mundshme të ngriten parat e gatshme në rast të pensionimit edhe pas qershorit 2007?

Po, në rast të pensionimit të rregullt apo pensionimit të mëhershëm ngritja e parave të gatshme të kapitalit të kursyer është edhe mëtej e mundshme, nëse kjo është e paraparë në rregulloren e Arkës tënde të pensionit. Qytetarët jashtë BE-së munden edhe më tutje – nëse lëshojné Zvicrën – të ngritin tërë kapitalin e kursyer.

A mund të tërheq parat përpara nëse blej hapsirë për banim?

Për blerjen e banesës apo shtëpisë për nevoja personale banimi, të siguruarit e moshës deri 50 vjeq mund të ngrisin një shumë deri në lartësinë e kapitalit që e kanë në dispozicion të lirë. Ai që kalon moshën 50 vjeqare, mund të ngrit vetëm kapitalin, të cilin ka mundur të ngritë në moshën 50 vjeqare ose gjysmën e kapitalit në kohën e ngritjes. Kjo vlenë edhe nëse bleni hapsirë banimi në shtetet e jashtme.

A jepet dëmshpërblim në kapital nëse bëhem i pavarur?

Ai/ajo i/e cila merret me një veprimtari të pavarur profesionale (hap një firmë dhe nuk është në marrdhënje pune) mund të ngritë kapitalin e kursyer të Arkës së pensionit. Kjo vlenë edhe për të huajt, të cilët ekonomikisht pavarsohen në Zvicër.

Kjo nuk vlenë në çdo rast për personat të cilët pavarsohen në njërin nga vendet e BE-së. Në shumicën e vendeve të BE-së të pavarurit janë të obliguar të paguajnë sigurime. Kjo varet, pra, nga ajo se a janë të pavarurit të siguruar në mënyrë të obligueshme në vendin e veprimtaris së tyre. Nëse janë të siguruar, atherë pjesën e obligueshme të kapitalit të kursyer nuk mund t'a tërhekin në para të gatshme.

Nëse e lëshoj definitivisht Zvicrën, por nuk e kam arritur moshën e pensionimit, a është atherë e mundur pagesa me para të gatshme?

Duke filluar nga 1 qershori, për qytetarët e BE-së nuk do të jetë e mundur të marrin para të gatshme për pjesën e obligueshme të kapitalit të kursyer, nëse personi vendoset në një shtet të BE-së dhe aty i nështrohet sigurimit të obligueshëm, d.mth. një njërin nga vendet e BE-së hyn në marrdhënje pune. Në këto raste pjesa e kapitalit të kursyer deponohet në një konto të kyçur banke ose jepet në formë të një polise të sigurimit, e cila mund të ngritet pesë vite para arritjes së moshës së rregullt të pensionimit. Se ku hapet ky konto apo një polisë e qarkullimit të lirë vendosë ti.

Tani për tani mosha e pensionimit të rregullt në Zvicër është: 64 për femra dhe 65 për meshkuj. Tërheqja e një pjese të kapitalit të kursyer në formë të parave të gatshme për blerjen e një vendi të banimit do të jetë e mundur edhe në të ardhmen. Për punëmarrësit e huaj, të cilët nuk janë qytetarë të BE-së, nuk do të ketë ndryshime edhe pas vitit 2007. D.m.th. ata mund të ngrisin kapitalin e kursyer në para të gatshme në rast të largimit definitiv nga Zvicëra. Revidimi (rishikimi) i përkujdesjes profesionale (shtylla e dytë) sjellë edhe disa ndryshime, të cilat vlejné për të gjithë punëmarrësit/punëmarrset në Zvicër. Këto sqarohen në pjesën që vijon.

Po, unë deklaroj anëtarësimin në Sindikatën Unia

Mbiemri	Emri i punëdhënësit
Emri	Shëgjert nga deri
Rruga	Gjuha e korrespondencës <input type="checkbox"/> D <input type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/> I
Kodi postal / vendi / shteti	Gjuha amtare
Data e lindjes	Vendi i ardhjes <input type="checkbox"/> B <input type="checkbox"/> C <input type="checkbox"/> L (Vlenë deri:.....)
Cellulari	Numri i Kontos bankare apo postare PC
eMail	Emri i bankës dhe vendi
Profesioni/Dega	Nënshtetësi
Unë jam përfutuar për anëtarësim në Sindikatë nga:	
Vendi/data	

Unë deklaroj anëtarësimin tim në Sindikatën Unia dhe obligohem për pagimin e rregullt të kuotave të shënuara (shih faqen mbrojtëse) përkatësisht sipas vendimeve të kuvendit. Unë pranojë statutet dhe rregulloret e Sindikatës Unia.